UDHËZUES I SHKURTËR PËR PUNONJËSIT SHËNDETËSORË:

MPOX (lija e majmunit)

HYRJE

MPOX është sëmundje infektive e shkaktuar nga virusi i lisë së majmunit (MPXV). Ekzistojnë dy shtame të ndryshme të virusit: clade I (me subclade Ia dhe Ib) dhe clade II (me subclade IIa dhe IIb). Historikisht, clade I është gjetur në Afrikën Qendrore (Pellgu i Kongos), ndërsa clade II në Afrikën Perëndimore, por epidemia e shkaktuar nga clade IIb po përhapet globalisht që nga viti 2022 përmes transmetimit nga njeriu te njeriu, veçanërisht përmes kontaktit seksual.

RRUGA E TRANSMETIMIT (transmetimi)

MPOX përhapet nga njeriu te njeriu kryesisht përmes kontaktit të afërt me një person të sëmurë, duke përfshirë edhe anëtarët e familjes. Kontakti i afërt përfshin kontaktin lëkurë me lëkurë (prekje ose marrëdhënie seksuale) dhe kontaktin e mukozave ose të lëkurës me mukozën (puthje), dhe mund të përfshijë edhe transmetimin nga njeriu te njeriu gjatë të folurit ose përmes grimcave respiratore infektive gjatë kontaktit të afërt të zgjatur.

Njerëzit gjithashtu mund të infektohen me Mpox nga sende të kontaminuara, si rrobat ose shtrojat e shtratit dhe sende të tjera.

Njerëzit që janë në kontakt të afërt me një person të infektuar, si anëtarët e familjes (përfshirë fëmijët), partnerët seksualë dhe punonjësit e seksit, si dhe punonjësit shëndetësorë, janë të ekspozuar ndaj një rreziku më të lartë për infeksion.

Dëshmitë e reja tregojnë se personat e infektuar mund ta transmetojnë MPXV deri në katër ditë para fillimit të simptomave. Periudha e infektueshmërisë zgjat derisa të gjitha lezionet e lëkurës të mbulohen me kore dhe të ndodhë riepitelizimi.

SHENJAT DHE SIMPTOMAT

Periudha e inkubacionit (intervali nga infektimi deri në fillimin e simptomave) i MPOX mund të variojë nga 1 deri në 21 ditë. Simptomat zakonisht zgjasin 2-4 javë, por mund të zgjasin më gjatë te personat me sistem imunitar të dobësuar.

Simptomat më të shpeshta të MPOX janë: skuqja e lëkurës, ethet, dhimbja e fytit, dhimbja e kokës, dhimbjet e muskujve, dhimbjet e shpinës, dobësia, nyjet limfatike të zmadhuara. Te disa persona, simptoma e parë është skuqja e lëkurës, ndërsa te të tjerë mund të jetë ethet, dhimbjet e muskujve ose dhimbja e fytit.

Skuqja e lëkurës zakonisht fillon në fytyrë dhe përhapet nëpër trup, duke përfshirë pëllëmbët dhe shputat. Mund të fillojë edhe në pjesë të tjera të trupit që kanë qenë në kontakt, si organet gjenitale. Fillon si një plagë e sheshtë, e cila më pas bëhet një flluskë e mbushur me lëng që mund të kruhet ose të jetë e dhimbshme. Gjatë shërimit, lezionet thahen, formojnë kore dhe bien.


Njerëzit mund ta transmetojnë sëmundjen derisa të shërohen të gjitha plagët dhe të formohet një shtresë e re e lëkurës. Disa njerëz mund të infektohen pa zhvilluar asnjë simptomë.

DIAGNOZA

Testi laboratorik i rekomanduar për Mpox është zbulimi i ADN-së virale me reaksion zinxhir të polimerazës (PCR). Mostrat më të mira diagnostike merren drejtpërdrejt nga skuqja - lëkurë, lëng ose kore. Në mungesë të lezioneve të lëkurës, testimi mund të bëhet me tamponë nga fyti ose anusi. Testimi i gjakut nuk rekomandohet. Metodat për zbulimin e antitrupave nuk janë të dobishme sepse nuk bëjnë dallim midis ortopoksviruseve të ndryshme.

Departamenti i Virologjisë pranë Institutit të Shëndetit Publik disponon reagentë për testimin me PCR. Udhëzimi bëhet nga specialisti dermatovenerolog ose infektolog sipas indikacioneve klinike, me njoftim paraprak dhe transport nga institucioni deri te Departamenti i Virologjisë pranë Institutit të Shëndetit Publik.

Rruga e lëvizjes së pacientit me dyshim për Mpox



Udhëzim i shkurtër për marrjen, transportin dhe ruajtjen e mostrës për detektimin e virusit të lisë së majmunit

1. **Gjithmonë duhet të merren të paktën dy mostra nga një pacient.**
2. **Dy lezione të të njëjtit lloj** duhet të mblidhen në një epruvetë, mundësisht nga lokacione të ndryshme të trupit që mund të dallojnë për nga pamja.
3. **Lezionet, koret dhe lëngjet vezikulare nuk duhet të përzihen në të njëjtën epruvetë.**
4. Gjaku i plotë me EDTA mund të përdoret për detektimin e MPXV, por mund të mos përmbajë nivel të lartë të virusit, pasi çdo viremi shfaqet herët gjatë infeksionit, zakonisht në periudhën prodromale dhe para se të shfaqen lezionet e lëkurës. Prandaj **nuk rekomandohet testimi i gjakut për detektimin e ADN-së virale.**
5. Lezionet makulo-papulare - kërkojnë biopsi invazive me punch - nevojiten trajnim dhe shkathtësi të avancuara. Biopsia e lezionit gjatë fazës makulare duhet të merret parasysh vetëm nëse është e indikuar klinikisht dhe të kryhet vetëm nga personel me trajnim adekuat.

Mostra për detektimin e MPXV

Lloji i mostrës	Materiali për marrjen e mostrës	Temperatura e ruajtjes dhe transportit
Material nga lezionet e lëkurës: (të rekomanduara) − Tamponë nga lezioni	Tamponë dakroni ose poliesteri me medium viral transportues ose tampon i thatë	Në frigorifer (2-8 °C) ose i ngrirë (-20 °C ose më poshtë) brenda 1 ore nga marrja;

- eksudat − shtresa e sipërme e lezionit − kore nga lezionet		-20°C ose temperatura më të ulëta nëse ruhet më gjatë se 7 ditë
Tampon orofaringeal	Tamponë dakroni ose poliesteri me medium viral transportues ose tampon i thatë	Njësoj si më sipër
Tampon rektal dhe/ose gjenital	Tamponë dakroni ose poliesteri me medium viral transportues ose tampon i thatë	Njësoj si më sipër
Urinë	Epruvetë sterile për marrjen e mostrës me kapak mbyllës	Njësoj si më sipër
Lëng seminal (spermë)	Epruvetë sterile për marrjen e mostrës me kapak mbyllës	Temperaturë dhome për <1 orë (pastaj -20°C ose më poshtë)
Trupi qelqor ose lëngu cerebrospinal (likvori)	Epruvetë sterile për marrjen e mostrës me kapak mbyllës	Temperaturë dhome për <1 orë (pastaj -20°C ose më poshtë)
Gjak i plotë	Epruvetë sterile për marrjen e mostrës me EDTA	Njësoj si më sipër
Serum/Plazmë	Epruvetë për ndarjen e serumit/epruvetë për marrjen e mostrës me EDTA	Në frigorifer (2-8 °C) ose i ngrirë (-20 °C ose më poshtë) brenda 1 ore nga marrja; -20°C ose temperatura më të ulëta nëse ruhet më gjatë se 7 ditë

Materiali i nevojshëm për marrjen e mostrave

- Tamponë dakroni ose poliesteri
- Medium viral për transport (2 ml medium) (mundësisht)
- Epruvetë sterile për marrjen e mostrës prej 2 - 4 mL me kapak mbyllës (mundësisht me vidë)
- Skalpel për përdorim të njëhershëm
- Pincetë për përdorim të njëhershëm
- Alkool për dezinfektimin e vendit të marrjes së mostrës
- Pajisje mbrojtëse personale
- Kuti për transportin e mostrave (së paku me paketa ftohëse të ngrira)
- Ligninë

MASAT E PARANDALIMIT për punonjësit shëndetësorë

- Përdorimi i pajisjeve mbrojtëse personale (PMP):
  - Maska (N95 ose FFP2/FFP3)
  - Doreza
  - Syze/mburoja të fytyrës
  - Veshje mbrojtëse
- Izolimi i rasteve të dyshuara dhe të konfirmuara.
- Kontakt i drejtpërdrejtë minimal.
- Dezinfektim i shpeshtë i sipërfaqeve dhe sendeve.
- Mbajtja e evidencës për kontaktet me personat e infektuar.

VAKSINIMI

Ekziston vaksina (JYNNEOS/Imvanex) e cila është efektive edhe kundër Mpox.

- Grupet e synuara: Punonjësit shëndetësorë, personeli laboratorik, personat me rrezik të lartë (kontaktet e rasteve të konfirmuara).

PARAQITJA DHE NJOFTIMI

- Çdo rast i dyshuar duhet të paraqitet në Qendrën e Shëndetit Publik.
- Respektimi i protokolleve për paraqitjen dhe gjurmimin e kontakteve.